

VENDIM
Nr. 59, datë 28.1.2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 422, DATË 6.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT E FUNKSIONIMIT DHE TRAJTIMIN FINANCIAR TË GRUPIT NEGOCIATOR DHE DETYRAT E KRYENEGOCIATORIT PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të vendimit nr. 749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të kreut I, të vendimit nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- a) Fjalët “Znj. Elsa Dhuli ...” zëvendësohen me “Znj. Lantona Sado ...”;
- b) Fjalët “Z. Arbjan Mazniku ...” zëvendësohen me “Z. Ervin Demo ...”;
- c) Fjalët “Znj. Mimoza Kaçi ...” zëvendësohen me “Znj. Adela Xhemali ...”;
- ç) Nënndarja “- Z. Sofjan Jaupaj, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit, negociator për kapitullin 27;” zëvendësohet me “- Z. Sofjan Jaupaj, ministër i Mjedisit, negociator përgjegjës për kapitullin 27;”;
- d) Nënndarja “- Znj. Orjana Osmani, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, negociator për kapitullin 26;” zëvendësohet me “Znj. Orjana Osmani, zëvendësministër i Arsimit, negociator përgjegjës për kapitullin 26;”;
- dh) Nënndarja “- Znj. Denada Seferi, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bashkënegociator përgjegjës për kapitujt 19 dhe 28;” zëvendësohet me “- Znj. Denada Seferi, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bashkënegociator përgjegjës për kapitujt 19 dhe 28;”;
- e) Nënndarja “- Znj. Olta Manjani, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitujt 2 dhe 3, si dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 19;” zëvendësohet me “- Znj. Olta Manjani, zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitujt 2 dhe 3, si dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 19;”;
- ë) Nënndarja “- Znj. Blerta Rama, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitullin 6 dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 4;” zëvendësohet me “- Znj. Blerta Rama, zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitullin 6 dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 4;”;
- f) Nënndarja “- Z. Besfort Lamallari, zëvendësministër i Brendshëm dhe negociator përgjegjës për kapitullin 24” zëvendësohet me “- Znj. Silva Caka, zëvendësministër i Punëve të Brendshme dhe negociator përgjegjës për kapitullin 24;”;

g) Nënndarja “- Znj. Ana Kapaj, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, negociator përgjegjës për kapitullin 25” zëvendësohet me “- Znj. Armela Baka, zëvendësministër i Arsimit, negociator përgjegjës për kapitullin 25;”;

gj) Nënndarja “- Z. Sokol Duma, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitujt 7 e 20;” zëvendësohet me “- Z. Martin Kajo, zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitujt 7 e 20;”;

h) Nënndarja “- Z. Endrit Yzeiraj, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 30;” shfuqizohet;

i) Në fund të nënndarjes “- Znj. Megi Fino, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, negociator përgjegjës për kapitullin 31 ...” shtohen fjalët “... dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 30;”;

j) Nënndarja “- Z. Enkelejd Musabelliu, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitullin 1 dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitujt 28 e 30;” zëvendësohet me “- Z. Enkelejd Musabelliu, zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitullin 1 dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitujt 28 dhe 30;”;

k) Nënndarja “- Znj. Erjona Çela, zëvendësministër i Financave, negociator përgjegjës për kriteret ekonomike dhe kapitullin 33;” shfuqizohet.

l) Në fund të nënndarjes “- Z. Andi Memeti, zëvendësministër i Financave, negociator përgjegjës për kapitullin 32 ...” shtohen fjalët “... dhe kapitullin 33;”;

ll) Nënndarja “- Z. Florian Semani, zëvendësministër i Financave, negociator përgjegjës për kapitujt 16 dhe 29;” zëvendësohet me “- Z. Endrit Yzeiraj, zëvendësministër i Financave, negociator përgjegjës për kriterin ekonomik, kapitujt 16 dhe 29;”;

m) Nënndarja “- Z. Arian Jaupllari, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, negociator për kapitujt 11 dhe 12;” zëvendësohet me “- Z. Arian Jaupllari, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, negociator përgjegjës për kapitullin 12;”;

n) Nënndarja “- Z. Roland Kristo, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, negociator për kapitullin 13;” zëvendësohet me “- Z. Fatmir Guri, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, negociator përgjegjës për kapitujt 11 dhe 13;”.

2. Ngarkohen grupi negociator i Republikës së Shqipërisë dhe institucionet, sipas pikës 1, të kreut I, të vendimit nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama